



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur me datë 14.04.2021 ndërmjet:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës (në tekstin vijues Komuna);
2. Qendra Kosovare për Studime Gjinore të cilën e përfaqëson znj. Luljeta Demolli, Drejtore ekzekutive (në tekstin vijues QKSGj);

Neni 1

Qëllimi

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim marrjen përsipër të detyrave dhe obligimeve që kanë të bëjnë me: Avancimin e përpjekjeve të përbashkëta për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit për shërbyesit/et civil/e; Avancimin e bazës ligjore dhe mekanizmave përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjin e Punës; Miratimin e Rregullores për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Administratën Publike.

Neni 2

Obligimet e Komunës

- 2.1. Organizimi i fushatës informuese rreth ngacimit seksual në vendin e punës në bashkëpunim me QKSGj;
- 2.2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Administratën Publike;

2.3. Vazhdimi i procedurave për miratimin e Rregullores për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Administratën Publike;

Neni 3 **Obligimet e “QKSGJ”**

- 3.1.** Obligohet që të ofrojë ekspertizë gjinore përkitazi me dokumentet që bijën në domenin e këtij memorandum bashkëpunimi;
- 3.2.** Të draftojë "Rregulloren për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Administratën Publike dhe të jetë pjesë e Komisionit dhe Grupit Punues, kur i kërkohet;
- 3.3.** Ta koordinojë në mënyrë transparente procesin e bashkëpunimit dhe përpilimin e draftit final të *Rregullores*;
- 3.4.** Të mbajë takime informuese dhe avokuese me përfaqësues/e komunalë/e për miratimin e *Rregullores*.

Neni 4

Ky Memorandum Bashkëpunimi është përpiluar në 2 (dy) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga 1 (një) i dorëzohet palëve nënshkruese.

Neni 5

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve, të cilat zotohen se të njëjtin do t'a zbatojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
Dokumenti hyn në fuqi pas momentit të nënshkrimit nga palët nënshkruese.

P A L Ë T

Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini



“Qendra Kosovare për Studime Gjinore”

Luljeta Demolli